



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.184/14.Prot

Tepelenë, më:01/02/2023

V E N D I M

Nr.14. Datë.31.01.2023

“Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasurinë nr.205 dhe nr.789 , ZK. 2541 , në fshatin Luzat Bashkia Tepelenë”.

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për qeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr.8743 date 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar; Ligjit nr. 8744 date 22.02.2001”Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njesite e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr.510 date 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave të transferimit e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara”; VKM 843 datë 06.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore , që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunes Qëndër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë r”; VKM 433/2016 ; mbështetur në të dhënat e Agjensisë Shtetërore te Kadastrës (ASHK) ,statusi juridik i pasurive.

VENDOSI:

1. Azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr.205 dhe nr.789 ZK 2541 fshati Luzat, të llojit “Kullotë” dhe përdorimin e këtyre pasurive për rrugën publike , për lidhjen e rrugës kryesore me parcelat bujqësore , kullotën dhe rrugët e tjera dytësore, sipas plen-vendosjes bashkangjitur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 13(trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13(trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 01.02.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

